



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:294441

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05876254

**P.nr.5338/19**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - Departamenti i Përgjithshëm**, me gjyqtarin e vetëm gjykues Bujar Ahmeti dhe praktikantin gjyqësor Sulltan Qallapeku, në çështjen penale kundër të akuzuarës E.D nga P, rruga "...", pa nr., për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 410 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), e akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, PP/II.nr.6753/2018 të datës 19.12.2019, pas përfundimit të seancës së shqyrtimit gjyqësor publik me datë 28.05.2024 në prezencën e Prokurorit të Shtetit Besart Mustafa, të dëmtuarave A.B dhe B.E dhe të akuzuarës E.D, me datë 31.05.2024 publikisht mori dhe shpalli, ndërsa me datë 28.06.2024, përpiloi këtë:

## **A K T G J Y K I M**

### ***E akuzuara,***

**E.D**, nga babai Xh dhe nëna F, mbiemri i vajzërisë se nënës M, e lindur me datë ... në fshatin P, Komuna e S, me vendbanim në P, rruga "...", pa nr., e pamartuar, punon, e gjendjes së mesme ekonomike, ka të kryer shkollën e mesme, shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës, e identifikuar me numër personal...

## **ËSHTË FAJTORE**

### ***Sepse:***

Me datë 13.11.2018, rreth orës 11:10, përderisa zyrtarët policor A.B dhe A.H ishin në lokalit në sheshin "...", në P, me të vërejtur të pandehurën e lartcekur duke e goditur me duar në fytyrë fëmijën e mitur që kërkonte lëmshë, reagojnë menjëherë ashtu që fillimisht e pyesin për arsyen e goditjes dhe i kërkojnë dokumentet e identifikimit, e njëjta nuk i përfill urdhrat e tyre, shfaq urrejtje, për çka detyrohen ta shoqërojnë për identifikim në stacionin policor, po ashtu e njëjta në kontinuitet tregohet shumë agresive si me sjellje edhe me fjalor të ndytë në atë mënyrë që me dashje fillimisht me çantën e krahut të saj ka tentuar ta sulmoj duke e hedhur në drejtim të të dëmtuarit A.B, mandej me duar disa herë ka tentuar ta sulmoj atë në trup edhe përkundër përpjekjes së të dëmtuarit që ti shmanget, e pandehura ka arritur ta prekë në të dy anët e kraharorit edhe e ka shtyrë, ndërkaq kur është kontrolluar nga zyrtarja policore B.E, pasi ia prezanton dokumentet e identifikimit në pyetjet e saja prapë ka shfaqur sjellje agresive dhe të pahijshme, ashtu që të dëmtuarën B.E e ka sulmuar

duke e goditur me duar në trup dhe duke e kapur për dore, me ç' rast ndërhyjnë zyrtarët tjerë policor për trajtim të këtij rasti.

- Me këto veprime ka kryer veprën penale *sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 410 par. 1 të KPRK-së.*

Prandaj, kjo gjykatë në bazë të neneve 4, 7, 17, 21, 41, 42 par. 1 pika 1.2, 49 par. 1 pika 1.1, 50, 51, 73, 74, nenit 410 par. 1 të KPRK-së dhe nenit 364, 449, si dhe 463 të KPP-së, të akuzuarën e:

## **G J Y K O N** **M E D Ë N I M M E K U S H T**

Të akuzuarës E.D i cakton dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindetëdhjetë (180) ditë, i cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej një (1) viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse e akuzuara brenda kësaj periudhe nuk kryen vepër të re penale.

I dëmtuari A.B për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil, ndërsa e dëmtuara B.E, në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore juridike.

E akuzuara obligohet që t'i paguajë shpenzimet e procedurës penale dhe atë: në emër të paushallit gjyqësor shumën prej 20 € (njëzet euro) dhe në emër të fondit për kompensimin e viktimave të krimit shumën prej 20 € (njëzet euro), të gjitha këto në afat prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

## **A r s y e t i m**

### *Rrjedha e procedurës dhe deklaratimet e palëve*

Prokuroria Themelore në Prishtinë, me aktakuzën e saj me numër PP/II.nr.6753/2018 të datës 19.12.2019, të akuzuarën E.D e ka akuzuar për shkak të veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 410 par.1 të KPRK-së.

Gjykata pas vlerësimit të kompetencës lëndore dhe territoriale dhe duke vepruar sipas aktakuzës, me datë 19.07.2022 ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit fillestar, në të cilin seancë e akuzuara nuk e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet dhe gjykata bazuar në dispozitat përkatëse ligjore e ka njoftuar të njëjtin për të drejtën e saj për ta kundërshtuar aktakuzën dhe pranueshmërinë e provave të paraqitura në aktakuzë. E akuzuara nuk ka paraqitur kërkesë për hudhje të aktakuzës dhe as kundërshtim të provave.

Gjykata me datë 30.04.2024 dhe me datë 28.05.2024, ka caktuar dhe mbajtur seancën e shqyrtimit gjyqësor, në të cilin seancë prezentë ishin Prokurori i Shtetit Besart Mustafa, të dëmtuarit A.B dhe B.E dhe e akuzuara E.R. Gjyqtari i vetëm gjykues në seancën e shqyrtimit gjyqësor e ka udhëzuar të akuzuarën për të drejtat konform nenit 319 të KPP-së. Pas kësaj, Prokurori i Shtetit e ka lexuar aktakuzën dhe pasi gjyqtari u bind se e akuzuara e ka kuptuar aktakuzën, bazuar në dispozitën e

nenit 321 par.1 të KPP-së të njëjtës i ofroi mundësinë që të pranojë fajësinë ose të deklarohet e pafajshme, me ç'rast e akuzuara është deklaruar se nuk e pranon fajësinë për veprën penale për të cilën akuzohet. Me qenë se e akuzuara nuk e ka pranuar fajësinë, në seancën e shqyrtimit gjyqësor është bërë administrimi i provave personale dhe materiale, si dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

*Përmbajtja e fjalës përfundimtare të palëve.*

Në fjalën përfundimtare Prokurori i Shtetit ka deklaruar se pas administrimit të provave personale dhe provave materiale si dëgjimit të dëmtuarit – dëshmitarit A.B, dëgjimit të dëmtuarës – dëshmitares B.E dhe provave materiale si procesverbali mbi marrjen në pyetje të dëmtuarit A.B, procesverbalit mbi marrjen në pyetje të akuzuarës, raportet e oficerëve policor, u vërtetua se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën është akuzuar, sepse në mënyrë identike të dëmtuarit edhe në raportet policore edhe në deklaratat e dhëna në prokurori dhe në gjykatë, kanë dëshmuar se e akuzuara i ka sulmuar zyrtarët policor të dëmtuarit A.B dhe B.E. Tutje në fjalën përfundimtare, Prokurori i Shtetit ka deklaruar se e akuzuara edhe në polici por edhe në gjykatë e ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje, kështu që bazuar në këto prova i ka propozuar gjykatës që të akuzuarën ta shpallë fajtores dhe ta dënojë sipas ligjit dhe me rastin e shqiptimit të dënimit të merren për bazë të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese, ku si rrethanë rënduese të merret numri i viktimave, kurse si rrethanë lehtësuese të merret sjellja e të akuzuarës pas rastit.

E dëmtuara BE në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështet fjalën e Prokurorit të Shtetit, njëherit ka shtuar se nuk parashton kërkesë pasurore juridike, ndërsa sa i përket ndjekjes penale ia len në vendosje gjykatës.

E akuzuara në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ka kryer këtë vepër penale dhe nuk është vërtetuar kryerja e veprës penale.

*Provat e administruara.*

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike në seancë të shqyrtimit gjyqësor, ka dëgjuar dëshmitarët A.B dhe B.E, si dhe të akuzuarën E.R, ndërsa nga provat tjera gjykata ka administruar procesverbalin mbi marrjen në pyetje në prokurori të dëmtuarit – dëshmitarit A.B i datës 10.10.2018, procesverbalin mbi intervistimin e të akuzuarës E.R në polici me datë 12.11.2018 si dhe raportet policor me numër të rastit ... të datës 13.11.2018 dhe pas vlerësimit të tyre një nga një dhe duke i ndërlidhur njëri me tjetrin në kuptim të nenit 360 par. 1 dhe 2 të KPP-së vërtetoi gjendjen faktike të përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

*Deklarata e të dëmtuarit A.B në cilësi të dëshmitarit.*

Dëshmitari në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 30.04.2024 ka deklaruar se ditën kritike ka qenë në pauzë të bukës së bashku me kolegun A.H dhe gjatë asaj kohe ka ardhur një fëmijë dhe ka filluar të lypë rreth tavolinave, kur ka shkuar tek e akuzuara pa kurrfarë arsye ka filluar ta godas një herë apo dy dhe ka qenë shumë agresive duke i bërtitur me një tonë të lartë. Tutje ka deklaruar se së bashku me kolegun A janë afruar tek pala dhe e kanë pyetur për arsyen se pse reagoi në atë formë, e njëjta ka shfaqur agresivitet ndaj tyre dhe sjelljet e saja kanë qenë të pakontrolluara, pastaj

i është kërkuar mjete i identifikimit ku e akuzuara nuk i ka përfill urdhrat e zyrtarëve policor dhe me qenë se kanë qenë afër stacionit policor, të njëjtën e kanë shoqëruar në stacion, ku pastaj është marr edhe zyrtarja policore B.E, pasi që është e gjinisë së njëjtë për kontrollimin e saj. Po ashtu, dëshmitari në seancë të shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se e akuzuara edhe në stacion policor ka shfaqur agresivitet ndaj koleges së tij BE, e akuzuara ka folur edhe fjalë të ndryshme banale në drejtim të koleges dhe në përgjithësi, ka qenë e revoltuar, pastaj e njëjta nga një distancë e largët e ka hudh në drejtim të tij një çantë të krahut por nuk e ka dëmtuar apo diçka të ngjashme, po ashtu ka filluar ta shtyjë me duar edhe zyrtaren B.E, ku pas 10 apo 15 minuta është qetësuar. Përveç kësaj, dëshmitari ka deklaruar se edhe gjatë rrugës duke u munduar të largohet i ka goditur zyrtarët policor, mirëpo goditjet nuk kanë qenë të masës me të cilat i ka dëmtuar të njëjtit.

#### *Deklarata e të dëmtuarës B.E në cilësi të dëshmitares.*

Dëshmitarja në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 28.05.2024 ka deklaruar se me sa i kujtohet se ka kaluar një kohë e gjatë, personi në fjalë është shoqëruar në stacionin policor nën dyshimin se ka qenë duke e sulmuar një person tjetër me anë të një thike dhe me të sjellë në stacion ku është futur në dhomën e intervistave, i njëjta ka qenë agresive dhe i ka sulmuar edhe zyrtarët policor dhe atë këtu të dëmtuarën B.E dhe të dëmtuarin A.B, në atë mënyrë që i ka sulmuar me duar dhe me sa i kujtohet edhe i ka gërvishtur.

#### *Mbrojtja e të akuzuarës*

E akuzuara E.D në mbrojtjen e saj ka shfrytëzuar të drejtën ligjore duke u mbrojtur në heshtje.

#### *Vlerësimi i provave dhe analizimi i gjendjes faktike.*

Në seancat e shqyrtimit gjyqësor në këtë çështje penale gjykata konform nenit 7 dhe 360 të KPP-së, saktësisht dhe në mënyrë të plotë vërtetoi faktet që janë të rëndësishme për marrjen e vendimit të ligjshëm, me vëmendje dhe përkushtim maksimal dhe me përkujdesje të njëjtë vërtetoi faktet kundër të akuzuarës si dhe ato në favor të saj duke i mundësuar të njëjtës shfrytëzimin e të gjitha fakteve dhe provave që janë në favor të mbrojtjes dhe me ndërgjegje vlerësoi çdo provë një nga një dhe në lidhje me provat tjera dhe në bazë të vlerësimit të tillë ka nxjerr përfundimin lidhur me faktet konkrete të vërtetuara, me ç'rast pas analizimit dhe vlerësimit të provave të cilat janë administruar në seancat e shqyrtimit gjyqësor ka ardhur në përfundim se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet sipas aktakuzës së prokurorisë.

Gjykata gjeti se në këtë çështje penalo juridike nuk ishte kontestues fakti se e akuzuara ditën kritike është gjetur në vendin në të cilin pretendohet se e ka goditur një fëmijë duke kërkuar lëmosh, po ashtu nuk ishte kontestuese se si rezultat i kësaj e akuzuara është shoqëruar në stacionin policor pasi nuk i ka përfill urdhrat e zyrtarëve policor lidhur me identifikimin e të njëjtës.

Kontestuese në këtë çështje penale juridike ishte fakti se nëse e akuzuara E.D i ka ndërmarr veprimet inkriminuese në drejtim të të dëmtuarve për të cilat pretendohet si në aktakuzë dhe atë se e njëjta me datë 13.11.2018 rreth orës 11:10 në stacionin policor i ka sulmuar të dëmtuarit – zyrtarët policor A B dhe B.E. Gjykata këtë fakt kontestues e zgjodhi duke u bazuar në provat personale dhe

materiale të administruara në seancën shqyrtimit gjyqësor, si procesverbali mbi marrjen në pyetje në prokurori të dëshmitarit A.B me datë 10.10.2019, si dhe nga dëshmia e dëshmitarëve A.B dhe B.E të dhënë në seancën e shqyrtimit gjyqësor.

Se e akuzuara e ka kryer veprën penale për të cilën është shpallë fajtores, gjykata këtë fakt e vërtetoi duke u bazuar në dëshminë e dëshmitarëve të dëgjuar në seancën e shqyrtimit gjyqësor dhe provave tjera materiale. Dëshmitari A.B ka deklaruar se ditën kritike e akuzuara ka shfaqur agresivitet ndaj tyre dhe sjelljet e saja kanë qenë të pakontrolluara, po ashtu, e njëjta ka folur edhe fjalë të ndryshme banale në drejtim të koleges dhe në përgjithësi, ka qenë e revoltuar, pastaj e akuzuara nga një distancë e largët e ka hudh në drejtim të tij një çantë të krahut por nuk e ka dëmtuar apo diçka të ngjashme, po ashtu ka filluar ta shtyjë me duar edhe zyrtaren B.E dhe se edhe gjatë rrugës për shoqërimin e të akuzuarës në stacion policor, duke u munduar të largohet i ka goditur zyrtarët policor, mirëpo goditjet nuk kanë qenë të masës me të cilat i ka dëmtuar të njëjtit. Këtë deklaram e ka mbështetur edhe dëshmitarja B.E e cila ka deklaruar se me të sjellë të akuzuarën në stacion ku është futur në dhomën e intervistave, i njëjta ka qenë agresive dhe i ka sulmuar edhe zyrtarët policor dhe atë këtu të dëmtuarën B.E dhe të dëmtuarin A.B, në atë mënyrë që i ka sulmuar me duar dhe me sa i kujtohet edhe i ka gërvishtur. Po ashtu, deklaramet e dëshmitarëve janë në përputhshmëri të plotë edhe me deklaramet e dëshmitarit A.B të dhënë në prokurori me datë 10.10.2019, kur ka deklaruar se e akuzuara pas ngjarjes së ndodhur ditën kritike ku e ka goditur një fëmijë duke kërkuar lëmosh, i ka sulmuar të dëmtuarit – zyrtarët policor dhe njëherit ka shfaqur agresivitet dhe sjelljet e saja kanë qenë të pakontrolluara, po ashtu këto deklaramet janë në përputhshmëri edhe me raportet e zyrtarëve policor, që po thuhet si në mënyrë identike e përshkruajnë ngjarjen që ka ndodhur me të akuzuarën.

Gjykata i ka vlerësuar deklaramet e këtyre dëshmitarëve dhe në mënyrë të pakontestueshme gjeti se të njëjtat përputhen me njëra tjetrën, nuk kanë kundërthënë në mes vete dhe provojnë faktin e ndërmarrjes së veprimeve inkriminuese të të akuzuarës në drejtim të sulmit ndaj të dëmtuarve – zyrtarëve policor gjatë kryerjes së detyrave zyrtare. Si rrjedhojë e kësaj, gjykata ka vlerësuar besueshmërinë dhe kredibilitetin e dëshmisë së dëshmitarëve A.B dhe B.E, dhe se deklaramet e këtyre dëshmitarëve i merr të besueshme për faktin se të njëjtit ishin paralajmëruar për detyrimin që të flasin të vërtetën, ishin paralajmëruar me pasojat për dëshminë e rremë, gjatë deklarameteve nuk është vërtetuar ndonjë shkelje e ligjit, deklaramet i kanë dhënë me vullnet pa asnjë presion, krejt në fund deklaramet i ka nënshkruar. Për këtë arsye deklaramet e dëshmitarëve janë plotësisht të besueshme për gjykatën, për arsye se deklaramet e tyre për faktet kryesore për këtë ngjarje, përputhen plotësisht me deklaramet e dëshmitarit A.B të dhënë më herët për këtë rast në prokurori, për më tepër, dëshmia e këtyre dëshmitarëve përputhet plotësisht edhe me provat materiale.

Me qenë se e akuzuara e ka shfrytëzuar të drejtën që të mbrohet në heshtje si në procedurën paraprake, ashtu edhe në shqyrtimin gjyqësor, ndërkaq në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e ka kryer këtë veprë penale, gjykata si rrjedhojë e kësaj ka shqyrtuar dhe analizuar edhe fjalën përfundimtare të të akuzuarës dhe ka gjetur se pretendimet e të njëjtës nuk qëndrojnë, ngase janë në kundërshtim me provat personale dhe materiale të administruara në këtë çështje penale.

*Gjendja faktike e vërtetuar.*

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat dhe nga provat të cilat janë administruar në këtë çështje penale, ka vërtetuar përtej dyshimit të bazuar mirë se në veprimet e të akuzuarës formohen të gjitha elementet e veprës penale sulm ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrave zyrtare, nga neni 410 par.1 të KPRK-së, të përshkruar sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi, e për të cilën veprë penale është paraparë dënimi me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet, dhe për këtë gjykata ka vendosur që të akuzuarën ta shpall fajtores dhe t'i shqiptoj dënimin me burgim, i cili dënim është kushtëzuar më afër të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, pasi që paraprakisht gjeti se e njëjta është penalisht përgjegjëse dhe se nuk ekzistojnë rrethanat të cilat e përjashtojnë përgjegjësinë penale të saj dhe se në veprimet e të akuzuarës manifestohen të gjitha elementet subjektive dhe objektive të kësaj veprës penale.

#### *Rrethanat me rastin e matjes dhe lartësisë së dënimit.*

Gjatë marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese të parapara si në nenin 73 dhe 74 të KPRK-së (i aplikueshëm në rastin konkret), të cilat ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit. Si rrethanë lehtësuese gjykata vlerësoi bashkëpunimin e të akuzuarës me gjykatën, sjelljen e të njëjtës pas kryerjes së veprës penale, se është hera e parë që e njëjta bie ndesh me ligjin, si dhe faktin se pala e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pasurore juridike, ndërsa si rrethanë rënduese përveç shkallës së përgjegjësisë penale të të akuzuarës, gjykata rrethanë tjetër rënduese nuk ka gjetur.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave lehtësuese dhe rënduese të elaboruara si më lartë, të akuzuarës i shqiptoj dënimin me burgim e të kushtëzuar më afër si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, duke vlerësuar se dënimi i shqiptuar në rastin konkret është i drejtë dhe i ligjshëm dhe në harmoni me peshën e veprës penale dhe përgjegjësinë penale të të akuzuarës dhe se me shqiptimin e dënimit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi do të arrihet edhe qëllimi i përgjithshëm i dënimit i paraparë në nenin 41 të KPRK-së, përkatësisht dënimi i shqiptuar është plotësisht i justifikueshëm, në përshtatje me rrethanat e kryerjes, rrezikshmërinë e veprës penale dhe të kryesit, po ashtu ky dënim do të shërbejë në parandalimin e të akuzuarës nga kryerja e veprave penale në të ardhmen (preventiva speciale), si dhe do të arrihet qëllimi që t'i përmbaj edhe personat e tjerë nga kryerja e veprës penale (preventiva gjenerale).

#### *Vendimi mbi kërkesën pasurore juridike*

Lidhur me kërkesën pasurore juridike gjykata vendosi duke u bazuar në nenin 462 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ku të dëmtuarin A.B, për realizmin e kërkesës pasurore juridike i udhëzoi në kontestin e rregullt juridiko civil, ndërsa e dëmtuara B.E në seancën e shqyrtimit gjyqësor ka deklaruar se nuk parashtron kërkesë pasurore-juridike, si rezultat i kësaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

#### *Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale*

Gjykata duke vendosur lidhur me shpenzimet e procedurës penale, në kuptim të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPP-së, obligoi të akuzuarën që në emër të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro). Po ashtu, konform nenit 36 par. 3 nën par. 3.1 të Ligjit Nr.08/L -109 për

Kompensimin e Viktimave të Krimit, gjykata e obligoi të pandehurin të paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro) në emër të Programit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Mbi bazën e të dhënave si më lart, e në bazë të neneve 242 dhe 364 të KPP-së, u vendos si dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.5338/19 datë 28.06.2024

**Praktikanti gjyqësor**  
Sulltan Qallapeku

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Bujar Ahmeti

---

s

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej tridhjetë (30) ditëve prej ditës së pranimi të këtij aktgjykimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.